



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca plenare**

Seanca nr. 02-24/11-06

Prishtinë, më 12 maj 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**P R O C E S V E R B A L**

Seancën e drejtuan **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit dhe **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë janë të pranishëm 75 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE:**

1. Shqyrtimi i gjendjes në Universitetin e Prishtinës

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin e rendin e ditës të kësaj seance. Ai tha se Universiteti i Prishtinës po kalon momente të vështira. Është më rëndësi të madhe që të gjejmë shtegun për kapërcimin e situatës. Duke qenë i sigurt se e kuptojmë të gjithë rëndësinë e këtij institucioni, kërkoj kontributin tuaj konkret për tejkalimin e gjendjes së krijuar në Universitetin e Prishtinës. Ta ndihmojmë Universitetin të zërë vendin që i takon në shoqëri, që të prodhojë dije dhe vizion për të ardhmen e Kosovës.

**Jakup Krasniqi**, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoj që në seancën e sotme të diskutohet për arsimin në tërësi dhe për Universitetin e Prishtinës në veçanti, sipas kërkesës së parashtruar.

**Nazim Jashari** (ORA) tha se mbështet kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së.

**Naim Maloku**, anëtar i kryesisë, tha se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 4 maj ka vendosur, për shkak të kohës dhe rëndësisë, tema e diskutimit të ndahet në dy pjesë: a) Situata në Universitetin e Prishtinës të shqyrtohet sot dhe b) Për gjendjen e arsimit në Kosovë të mbahet seancë e veçantë, pas përgatitjeve të nevojshme.

**Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë, kërkoj 15 minuta pauzë për konsultime të Grupit Parlamentar të PDK-së.

**Kryetari** dha 15 minuta pauzë.

Pas pauzës, **Jakup Krasniqi** tha se Grupi Parlamentar i PDK-së, pas konsultimeve të bëra, pajtohet që në seancën e sotme të diskutohet për situatën në Universitetin e Prishtinës, por kërkon që Kuvendi sot ta caktojë datën e mbajtjes së seancës tjetër për të shqyrtuar gjendjen në arsimin e Kosovës në tërësi.

**Kryetari** tha se paraprakisht duhet të bëhen përgatitjet e nevojshme për ta caktuar datën e mbajtjes së seancës për shqyrtimin e gjendjes së arsimit në tërësi. Sot, Kuvendi i vazhdon punimet me shqyrtimin e situatës në Universitetin e Prishtinës.

Ai ia dha fjalën parashtruesit të kërkesës për diskutimin e sotëm.

**Deputeti Enver Hoxhaj**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se kemi kërkuar seancë të veçantë me qëllim arsimi në Kosovë është pa vizion, kurse ministri i Arsimit nuk është në gjendje të thotë se cilat janë prioritetet e tij në fushën e arsimit. Arsimit në Kosovë, prej çerdheve, shkollave fillore, shkollave të mesme, Universitetit të Prishtinës e deri te Akademia e Shkencës është i politizuar tej mase.

Universiteti i Prishtinës në të kaluarën ishte shtyllë kryesore e emancipimit të gjithë qytetarëve të Kosovës, por edhe të gjithë shqiptarëve në ish- Jugosllavi. Kuvendi i Kosovës, që ka qenë edhe themelues i Universitetit (1969), do të duhej të ketë përgjegjësi, të gjejë rrugë, të ofrojë zgjidhje dhe ta caktojë drejtimin se kah do të duhej të shkojë Universiteti i Prishtinës.

Më lejoni t'i paraqesë disa argumente që ilustrjnë se Udhëzimi Administrativ i MASHT është masë e dhunshme në Universitetin e Prishtinës:

1. Udhëzimi Administrativ është instalim i logjikës së dhunës institucionale, ngase sa herë të ndërrohen qeveritë mund të ndërrohet edhe rektori i Universitetit të Prishtinës. Është logjika dhe kultura e diktatit, që mjerisht Kosovën e ka përcjellë në të kaluarën dhe nuk do të duhej ta përcillte deri më sot.

2. Argumenti i dytë ka të bëjë me Komisionin Zgjedhor, i cili propozohet në Udhëzimi Administrativ, ku në nenin e parë thuhet: “Komisioni Qendror Zgjedhor i UP-së themelohet brenda tri ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe përbëhet nga tre anëtarë: një ekspert për zgjedhje i emëruar nga OSBE-ja, një ekspert i statutit i emëruar nga ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe sekretari i përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës. Përbërja e tillë i përjashton më së 30.000 njerëz, studentë, akademikë që janë përfaqësues të Universitetit të Prishtinës.

3. Argumenti i tretë ka të bëjë me kohën e mbajtjes së zgjedhjeve. Ky udhëzim administrativ është në kundërshtim me Statutin e Universitetit të Prishtinës, që parasheh se Senati i shpall zgjedhjet në Universitetin e Prishtinës, e jo Ministria.

4. Argumenti i katërt ka të bëjë me nenin e tretë UA të MASHT, ku thuhet: “Për çdo vonesë në dinamikë duhet të raportohet te ministri i Arsimit, duke e informuar atë plotësisht”. Nenet 5, 6 dhe 7 parashohin se si zgjidhen organet e Universitetit të Prishtinës, por nuk është e qartë se si ë zgjidhet rektorit.

Ky udhëzim administrativ nuk është asgjë tjetër vetëm se mllef i Ministrisë së Arsimit ndaj Universiteti i Prishtinës.

Për të dal nga kjo situatë propozoj me sa vijon:

1. Të shfuqizohet Udhëzimi Administrativ i MASHT për Universitetin e Prishtinës.
2. Të caktohet një pale e tretë për t'i zgjidhur çështjet ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
3. Universiteti i Prishtinës të depolitizohet. Këshilltarët e kryeministrit të mos jenë anëtarë të Këshillit të Universitetit, as dekanët e fakulteteve të mos jenë njerëz që kanë funksione partiake.
4. Të zgjidhet një rektor i përkohshëm ose ushtrues i detyrës së rektorit, që do ta ruante neutralitetin dhe do të garantonte që zgjedhjet në Universitetin e Prishtinës të jenë të lira dhe demokratike.

**Kryetari** ia dha fjalën ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ministri **Agim Veliu**, para deputetëve të Kuvendit, e arsyetoi bazën ligjore të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë për Universitetin e Prishtinës.

Në vazhdim ministri **Veliu** tha se Qeveria dhe Ministria e Arsimit është dashur të veprojmë në këtë formë për të vendosur ligjshmërinë në Universitetin e Prishtinës.

Universitetit i Prishtinës tani po hyn në muajin e 18 me një udhëheqësi të përkohshme dhe jo legjitime.

Deklarata e donatorëve kryesor ndërkombëtarë për Universitetin e Prishtinës tregon se durimit të miqve tanë po i vjen fundi. Ata kërkojnë nga ne që të mbështesim Rregullën dhe Ligjin që të kenë mundësi të vazhdojnë përkushtimin e tyre.

Udhëzimi Administrativ nr. 37/2005 i Ministrisë së Arsimit i miratuar nga Qeveria e Kosovës e ka rregulluar qeverisjen e përkohshme pas shkarkimit të udhëheqjes jo legjitime të Universitetit. Zyrtarët e lartë të ngarkuar, përveç përgjegjësive administrative, është dashur të organizojnë edhe mbajtjen e zgjedhjeve.

Zgjedhjet studentore kanë përfunduar me sukses të madh, për të cilat të gjithë ne pajtohemi. Rekomandimet e Grupit të ekspertëve për rizgjedhjet nuk u mbajtën. Zyrtarët e lartë nuk i kanë mbajtur rizgjedhjet ashtu si parashihet në Udhëzimin Administrativ.

Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nr.11/2006 përgatit kornizën organizative për mbajtjen e zgjedhjeve në këshillat e fakulteteve, të Senatit që t'i përcjell të gjitha procedurat e tjera deri në zgjedhjen e rektorit të ri.

Ky udhëzim është i ndërtuar mbi konceptin e suksesshëm të Komisionit Zgjedhor të zgjedhjeve studentore, i njëjti grup i OSBE-së dhe eksperti i Statutit janë të ngarkuar që të bëjnë organizimin e të gjitha zgjedhjeve në vazhdimësi. Komisionit Qendror Zgjedhor i është dhënë përgjegjësia të organizojë të gjitha zgjedhjet e domosdoshme në atë mënyrë që të mundësohet zgjedhja e rektorit para pushimeve verore.

Neni 12 i këtij udhëzimi i jep autoritet ministrit të vendosë masat disiplinore për të gjitha organet qeverisëse të Universitetit, kur ata nuk u përmbahen rregullave të këtij udhëzimi. Proces i vendosjes së qeverisjes së ligjshme në Universitet është mundësuar në bazë të punës së përkushtuar të Grupit të ekspertëve, që i falënderoj për punë e bërë.

Të arriturat e Komisionit Zgjedhor, që nga enjtja. Nga 17 fakultete sa janë, 14 prej tyre i kanë dorëzuar listat e votuesve, ndërsa 12 fakultete i kanë nominuar anëtarë të tyre në komisionet zgjedhore të fakulteteve. Gjatë këtyre ditëve ky proces duhet të kompletohet në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 11/2006. Përgatitjet e fundit për zgjedhje fillojnë nga e hëna në javën e ardhshme kur fillon të bëhet konstituivi i komisioneve zgjedhore të fakulteteve. Listat e votuesve do të publikohen të hënën, kurse të martën kandidatët do të kenë kohë prej 6 orësh që të nënshkruajnë kandidaturën e tyre në prani të Komisionit Zgjedhor të fakultetit. Lista e kandidatëve do të publikohet që nga e mërkura, të premtën më 19 maj është paraparë dita e zgjedhjeve për personelin akademik dhe jo akademik, për këshillat e fakulteteve dhe për Senat.

Deri në fund të qershorit do të zgjidhet edhe rektorit i Universitetit.

**Kryetari** e hapi diskutimin për shqyrtimin e situatës në Universitetin e Prishtinës.

**Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se i bashkëngjitet përpjekjeve të vendorëve dhe të ndërkombëtarëve për tejkalim të gjendjes aktuale dhe angazhimit për zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë profesionale dhe shkencore në Universitetin e Prishtinës. Dituria është shansi i vendit tonë dhe duhet investuar në të. Në kohë të ndërtimit të institucioneve demokratike të Kosovës, garantimi i burimit të pashtershëm të ditorisë është esencial, vendit tonë i nevojitet Universiteti i kohës në të cilën jetojmë. Universiteti i integruar dhe jo i izoluar nga bota e dijes.

Për integritet të kohës në të cilën jetojmë dhe konkurrencë në dituri, kërkojmë frymë bashkëpunimi dhe respekti institucional e jo konflikti e anarki.

Universiteti ynë është i izoluar. Nga kjo gjendje, sa do e rëndë që është, zgjidhja është në zgjedhje, të mbikëqyrura nga institucionet përkatëse prestigjioze dhe pa ndërhyrje politike.

Ne jemi të përcaktuar për respektim të autonomisë akademike dhe angazhohemi për zhvillim të Universitetit, mbështetur në ligjshmëri dhe në sjellje institucionale.

**Gjylnaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së. tha se problemet në Universitetin e Prishtinës nuk janë të ditës së sotme.. Kanë dështuar disa tentime radhazi që të vihen rregulli dhe ligjshmëria në Universitet. Ka pasur tendenca të shumta që Universiteti të politizohet për interesa të ndryshme që dëshirojnë të krijojnë monopol në këtë institucion.

Duhet të jetë e qartë për të gjithë se nuk mund të ketë askush pronësi dhe as monopol mbi Universitetin. Ne mbështesim autonominë e Universitetit, por nuk mund t'i mbështesim ato struktura që në emër të autonomisë nuk përfillin ligjin, i bojkotojnë reformat dhe politizojnë këtë institucion. Qeveria e Kosovës ka vendosur që t'i shpall zgjedhjet e reja në Universitet, qe edhe ne i mbështesim. Askush nuk ka nevojë të frikësohet nga zgjedhjet e reja në Universitet.

Ne jemi të përkushtuar që të sigurohet funksionimi normal i Universitetit dhe për realizimin e këtij qëllim, rekomandojmë:

1. Zbatimin e ligjshmërisë në fuqi, Statutin e Universitetit dhe Ligjin për arsimim të lartë dhe këtu në veçanti mbajtja e zgjedhjeve të përgjithshme të lira nën monitorimin e OSBE-së.
2. Zbatimi i pagesës vjetore gjithëpërfshirëse të studentëve ashtu siç është përcaktuar me rregullore. Marrëveshja ndërmjet MASHT-it dhe Universitetit të Prishtinës
3. Ndërtimi i sistemit të qëndrueshëm për financimin e Universitetit të Prishtinës.
4. Zbatimi i reformave në Universitet duhet të bashkërenditet me MASHT-it, MTI, MEF, ME, MTPT për shkollimin e profileve të nevojshme për zhvillimin e vendit.

**Genc Gorani**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s tha se kriza e thellë në Universitetin e Prishtinës është çështje e prioritetit më të lartë e Kuvendit të Kosovës, ngase është themelues i tij. Qeveria dhe Ministria e Arsimit kanë për detyrë të zbatojnë ligjet dhe rregulloret për funksionimin e drejtë të Universitetit. Universiteti me vite të tëra është bërë arenë e përplasjeve partiake, ideologjike të influencave të tjera jo akademike.

Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji nuk ka arritur t'i sigurojë kushtet për funksionimin korrekt, efikas, ligjor dhe në frymën e Ligjit për arsimin e lartë. Veprimet e Ministrisë në këtë fushë, por edhe në fushën e arsimit parauniversitar janë me prapavija të forta pro partiake me qëllim të kontrollit partiak të sistemit arsimor.

Ministria thirret në Ligjin për arsimin e lartë, por është ajo që nuk i zbaton ato pjesë të ligjit që do ta ndihmojnë Universitetin në funksionimin e tij ligjor. Ministria refuzon me vite të tëra themelimin e Agjencisë për Akreditim

Për ne Ministria është pjesë e krizës. Vendimet e Ministrisë dhe të Qeverisë nuk mund të përkrahen, ngase janë të njëanshme, nuk marrin parasysh realitetin dhe janë diktatoriale. Është momenti i fundit që Kuvendi i Kosovës, si themelues i Universitetit të Prishtinës të marrë përsipër t'i sigurojë kushtet për zgjidhjen e krizës në Universitet.

Propozoj të formohet një Komision i veçantë i Kuvendit për dalje nga kriza dhe të sigurojë funksionimin autonom të Universitetit.

**Ferid Agani**, në emër të Grupit Parlamentar “Për Integrim, tha se Universiteti i Prishtinës, si pjesë e shoqërisë dhe vend i traumatizuar pas luftës është ballafaqua me situatë tejet të rëndë ekonomike dhe financiare në rrethana të statusit të padefinuar politik, me synime fisnike për arritjen e standardeve ndërkombëtare dhe inkuadrimit në Bashkësinë e Universiteteve Evropiane Universiteti i Prishtinës ishte në tension të vazhdueshëm ndërmjet realiteti të lartë dhe synimeve tejet ambicioze. Si rezultat i këtyre faktorëve dhe i zhvillimeve në shumë momente është manifestuar nguti dhe nervozizëm në vendimmarrje, ndonjëherë edhe veprime të pamatura.

Për tejkalimit e situatës së krijuar në Universitetin e Prishtinës ai propozoi që Kuvendi të marrë vendim me sa vijon:

1. Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 03/196 i datës 26 prill 2006 duhet të fillojë të zbatohet prej 1 shtatorit 2006.
2. Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që Komisioni Qendror Zgjedhor të plotësohet me një profesor të emëruar nga Senati i Universitetit të Prishtinës dhe një student të emëruar nga Parlamenti i studentëve duke siguruar përfaqësimin adekuat gjinor.
3. Qeveria e Kosovës dhe Universiteti i Prishtinës duhet të sigurojnë depolitizimin e plotë të Universiteti të Prishtinës dhe sigurimin e autonomisë së tij, në pajtim me ligjin.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për situatën në Universitetin e Prishtinës dhanë edhe këta deputetë: **Gani Koci, Numan Baliq, Teutë Hadri, Xhevat Bislimi, Nimon Alimusaj, Dritë Statovci, Sala Ahmetaj, Emrush Xhemajli, Veton Surroi, Ymer Halimi, Sadudin Berisha, Hajredin Kuçi, Sabri Hamiti, Ramë Buja, Sokol Bashota, Mark Krasniqi, Selvije Halimi, Hydajet Hyseni, Jakup Krasniqi dhe Mazllom Kumnova**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

**Kryesuesi** seancën e sotme e deklaroi të mbyllur në orën 17:10 minuta për t'i vazhduar punimet të hënën, në orën 10:00.

E hënë, 15 maj 2006

**Vazhdim i seancës**

Seancën e kryesoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Në fillim të seancës ishin të pranishëm 65 deputetë.

**Kryesuesi** e hapi diskutimin për shqyrtimin e situatës në Universitetin e Prishtinës.

Në vazhdim të seancës për situatën në Universitetin e Prishtinës diskutuan edhe këta deputetë: **Afrim Arzallxhiu, Hatixhe Hoxha, Fetah Berisha, Xhevat Bislimi, Nait**

**Hasani, Gjulshen Berisha, Hajredin Hyseni, Fehmi Mujota, Nazim Jashari, Ramadan Musliu, Xhavit Haliti, Bajrush Xhemajli, Zylfi Merxha, Berat Luzha, Behxhet Brajshori, Hajredin Kuçi, Ymer Muhaxheri, Ilaz Pireva, Ragip Zekolli, Kamber Kamberi, Gani Koci, Naim Maloku, Safete Hadërgjonaj, Shaban Halimi, Nekibe Kelmendi dhe Jakup Krasniqi,** që i janë bashkangjitur stenogramit.

Në fund, ministri Veliu iu përgjigj pyetjeve dhe vërejtjeve të deputetëve.

**Enver Hoxhaj,** në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së - propozues i këtij debati, përsëriti kërkesat e paraqitur në fillim të debatit, për të cilat kërkoi të votohet.

Kryesuesi i seancës, **Sabri Hamiti,** pas përmbledhjes së diskutimeve për situatën në Universitetin e Prishtinës, dha pauzë me qëllim që kryetarët e grupeve parlamentare t'i harmonizonin qëndrimet për rekomandimet e kësaj seance.

Pas pauzës, kryetarët e grupeve parlamentare paraqitën qëndrimet e tyre për tejkalimin e situatës në Universitetin e Prishtinës, duke shtuar se në tekstin e propozuar të rekomandimeve, prej nëntë pikash, gjashtë prej tyre janë harmonizuar, kurse tri kanë mbetur pa u harmonizuar.

**Kryesuesi,** në përmbyllje të debatit dyditor, tha se kryetarët e grupeve parlamentare nuk kanë arritur t'i harmonizojnë qëndrimet për tekstin përfundimtar të rekomandimeve të Kuvendit për tejkalimin e situatës në Universitetin e Prishtinës.

Kryetarët e grupeve parlamentare duhet të vazhdojnë punën për harmonizimin e rekomandimeve dhe t'ia paraqesin Kuvendit për miratim.

**Kryesuesi** e deklaroi seancën të mbyllur në orën 15:55 minuta.

E hartoi

**Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

\_\_\_\_\_